



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 2746

NR. VENDIMI 2137



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.	1475/2746	Akti
Nr. 2137 Vendimi		
Data e regjistrimit 20.05.2021/01.07.2021		Data e vendimit 08.07.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE: ARMELA HASANTARI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Berzana Çobo**, sot më datë 08.07.2021 pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale Nr. 1475/2746 Regjistri Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Robert Kote**.

I PANDEHUR:

Ervis Loga, i biri i Agim dhe i Fatmira, i dtl. 24.10.1984, lindur dhe banues në Tiranë, me gjëndje civile i martuar, me arsim të mesëm, me gjëndje gjyqësore i padënuar më parë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi personal “Arrest në burg”, mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga Av. Melina Gjeta, me nr. 10688 liçense dhe Nipt L91713014J, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e vepres penale të **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

I PANDEHUR:

Aredi Skora, i biri i Rakip dhe i Florinda, i dtl. 12.09.1995, lindur

dhe banues në Tiranë, fshati Verri, banesë private pa nr., me gjëndje civile beqar, me arsim të mesëm, me gjëndje gjyqësore i dënuar më parë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga Av. Melina Gjeta, me nr. 10688 liçense dhe Nipt L91713014J, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të “**Moskallzimi i krimi**”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Robert Kote, në prani të të pandehurve Ervis Loga dhe Aredi Skora, në prani të mbrojtëses së tyre Av. Melina Gjeta, Gjykata, pasi dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilat kërkuan:

Prokurori: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Loga**, për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim. Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale; 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aredi Skora**, për veprën penale të “Moskallzimi i Krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale; Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për një kohë prove prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh dhe caktimin e masave të parashikuara në nenin 60/9 të Kodit Penal. 3. Në kuptim të nenit 190 të K.Pr.Penale, asgjesimin e lëndës narkotike të sekuestruar me procesverbalin përkatës. 5. Detyrimin e të pandehurve për pagimin e shpenzimeve procedurale dhe gjyqësore.

Mbrojtësi i të pandehurit Ervis Loga: Dënimin e shtetasit Ervis Loga në një masë sa më të butë. Në lidhje me vuajtjen e dënimit kërkojmë që gjykata të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal për shtetasin Ervis Loga.

I pandehuri Ervis Loga: Dakord me mbrojtësin. Jam shumë i penduar.

Mbrojtësi i të pandehurit Aredi Skora: Dënimin e shtetasit Aredi Skora në masën e paraburgimit që ka kryer.

I pandehuri Aredi Skora: Dakort me mbrojtësin. Jam shumë i penduar.

VËREN:

I. Rrethanat e faktit.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në datë 20.05.2021, depozitojë në Gjykatë, kërkesën penale me objekt: “*Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Ervis Loga, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal dhe të pandehurit Aredi Skora, i*

akuzuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal”. Me shortin e datës 21.05.2021, kjo kërkesë i kalojë për shqyrtim këtij trupi gjykues. Në zbatim të neneve 332 e vijues të K.Pr.Penale, nga ana e Gjykatës u caktua seanca paraprake, duke u njoftuar prokuroria dhe të pandehurit. Në seancën e datës 01.07.2021, Gjykata pasi verifikojë paraqitjen e palëve, në zbatim të nenit 332/c të K.Pr.Penale, deklarojë të hapur shqyrtimin gjyqësor. Pas parashtrimit të kërkesës dhe provave nga prokurori, të pandehurit dhe mbrojtësi i tyre paraqitën kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar.

2. Nisur nga kërkesa për gjykim të shkurtuar e paraqitur nga të pandehurit Ervis Loga dhe Aredi Skora në seancë paraprake, Gjykata iu referua parashikimeve të nenit 332/dh, pika 1, germa c) të K.Pr.Penale, e cila nën titullin *“Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake”*, ndryshuar shkronja “b” dhe “c”, shtuar shkronja “d” e pikës 1 me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, parashikon se: *“1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë...”*. Gjykata vlerëson se me ndryshimet që iu bënë K.Pr.Penale, me Ligjin Nr. 41/2021, datë 23.03.2021, nëse kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet në seancë paraprake, ajo nuk mund të refuzohet për asnjë arsye. Ajo në çdo rast duhet pranuar, me kushtin që Gjykata të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë kërkesat e palëve për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera, si dhe kërkesën e të pandehurit për të dhënë deklarime ose të kërkojë të pyetet. Me marrjen e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar dhe verifikimit të gjendjes së akteve, Gjykata fton palët në bisedimet përfundimtare, duke iu dhënë atyre kohën e nevojshme për ti përgatitur, por jo më gjatë se 15 ditë.

3. Në rastin konkret, Gjykata nuk konstatojë pengesa nga ato të parashikuara nga neni 332/c i K.Pr.Penale dhe për këtë arsye vendosi ta pranojë kërkesën e të pandehurve Ervis Loga dhe Aredi Skora, për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Gjykata vlerëson se çështja penale në ngarkim të të pandehurve dhe akuza e ngritur ndaj tyre, nuk do të jetë më në kuadrin e provave të mjaftueshme për dërgimin e çështjes për gjykim, por do të jetë në kuadrin e provimit të akuzave ndaj tyre tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në kushtet e procedimit me gjykim të shkurtuar, duke prezumuar pranimin nga palët e të gjitha akteve dhe provave të grumbulluara në fazën e hetimeve paraprake dhe duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre çmon të provuar faktin si më poshtë:

4.1 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë mbi bazën e materialeve proceduriale të ardhura për kompetencë hetimi nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, Sektori kundër narkotikëve, më dt.15.12.2020 është rregjistruar procedimi penal me nr.8922/2020 fillimisht për veprën penale të “Prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike” e kryer në bashkëpunim sipas nenit 283/2 të K.P në ngarkim të personave nën hetim Ervis Loga dhe Aredi Skora.

4.2 Më datë 14.12.2020, nga ana e Seksionit të Narkotikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë së Tiranës është marrë informacion në rrugë konfidenciale dhe operative se të pandehurit Ervis Loga dhe Aredi Skora merren me shitjen e lëndës narkotike Cannabis Sattiva në zonën e fshatit “Shëngjergj”-Tirane. Rreth orës 14:00 është organizuar shërbim duke shkuar në afërsi të këtij fshati ku janë vendosur shërbime në vende të ndryshme në vendet e quajtura

lumi Erzen, në hyrje të fshatit Shëngjergj dhe në fshatin Shëngjergj, të cilat kanë qenë me automjet dhe në lëvizje të vazhdueshme. Në hyrje të fshatit Shëngjergj, sapo kalon lokalit e quajtur “Selim Veli”, buzë rrugës janë konstatuar të pandehurit Ervis Loga dhe Aredi Skora, të cilët po mbanin në dore një pëlhurë (copë/lecke) dhe kanë zbritur që të dy personat në buze të rrugës. Duke pasur dyshime se këta dy të dyshuar mbanin lëndë narkotike të llojit cannabis sativa nga ana e policisë gjyqësore është bërë ndërhyrja për t’i arrestuar në flagrancë të dyshuarit e mësipërm pra në kryerje e sipër të vepres penale, duke u prezantuar si punonjës policie dhe në këtë moment i pandehuri Ervis Loga ka tentuar që të largohet ku pak metra më larg është bërë kapja e tij si dhe prangosja e të pandehurit tjetër Aredi Skora.

4.3 Pasi është hapur pëlhura, e cila ishte lidhur është konstatuar një qese plastike ngjyrë e zezë ku brenda saj ka material bimor në gjëndje të tharë në forme boçesh me aromë dhe karakteristika si ato të lëndës narkotike cannabis sativa. Është bërë kontroll i banesave të dy të pandehurve dhe nuk i janë gjetur ndonjë send i kundraligjshëm.

4.4 Pasi u bë sekuestrimi i sasisë me lëndë narkotike të dyshuar si cannabis sativa, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme me amballazh **6.8 (gjashtë pikë tetë)** gram e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me **Nr.UNIK. C10019162**.

4.5 Rreth këtij fakti penal janë kryer veprimet e para hetimore duke filluar me kontrollin e banesave ku në secilin prej tyre nuk u gjetën sende të kundërligjshëm si dhe janë marrë vendimet përkatese të ekspertimit kimik dhe toksikologjik. Rreth këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore ku midis të tjerash është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi Ervis Loga, i cili në deklaratimet e tij të datës 08.04.2021, ka pohuar autorësinë në kryerjen e kësaj vepreje penale duke treguar me detaje rrethanat e çështjes duke sqaruar se lënda narkotike e cila është gjetur dhe sekuestruar nga shërbimet e policisë gjyqësore i përket atij dhe se e ka gjetur sipas pretendimeve të tij në pyll duke prerë dru, duke plotësuar se personi nën hetim Aredi Skora nuk ka lidhje me këtë fakt dhe se nuk ka pasur dijeni për lëndën narkotike në fjalë madje këtë fakt e ka pohuar edhe gjatë seancës gjyqësore të vleftësimit dhe të caktimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj tyre para gjykatës.

4.6 Të njëjtin fakt ka pohuar dhe personi tjetër nën hetim Aredi Skora, i cili në deklaratimet e tij si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet ka mohuar autorësinë në kryerjen e kësaj vepre penale dhe se nuk ka pasur dijeni që i dyshuari tjetër tek qesja plastike të ketë pasur lëndë narkotike dhe se me këtë të fundit sipas pretendimeve të tij është takuar rastësisht.

4.7 Sa sipër organi i akuzës nisur nga ky fakt duke parë rrethanat e çështjes dhe provat e administruara në tërësi cmon se për të dy personat nën hetim Ervis Loga dhe Aredi Skora duhet të ndryshohet cilësimi juridik i faktit penal që ju është atribuar fillimisht pra duke akuzuar përfundimisht personin nën hetim Ervis Loga për faktin penal të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal dhe për personin tjetër Aredi Skora të vazhdojë ndjekjen penale për faktin penal të parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

4.8 Kështu në urdhërin për pasqyrimin e ndryshimit të cilësimit juridik të dt.15.04.2021 të Prokurorit të çështjes ndër të tjera është argumentuar se për personin nën hetim Ervis Loga duhet të ngrihet akuza për faktin penal të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”, sipas nenit 283/1 i K.Penal pasi nuk u vërtetuan elementë bashkepunimi midis tij dhe të dyshuarit tjetër Aredi Skora. Në vazhdim hetimet rreth këtij procedimi penal kanë vazhduar me administrimin e akteve kimik, toksikologjik dhe teknik për secilin nga provat materiale të

sekuestruara, të cilat i përkasin të pandehurve të mësipërm.

5 Në lidhje me lëndën narkotike e dyshuar si e llojit cannabis-sative, e cila i është gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale të pandehurit Ervis Loga **me Aktin Kimik me nr.1262, dt.03.02.2021 është konkluduar se:** *“Materiali bimor objekt ekspertimi është cannabis produkt herbal bimë cannabis sativa L dhe se pesha në total me ambalazh është 6770 gram”*.

5.1 Sipas Aktit të Ekspertimit Toksikologjiko - Ligjor me nr.2742 dhe 2743, dt.28.12.2020 ku me të cilin konkludohet se: *“Në monstrën e urinës të marrë nga të pandehurit Ervis Loga dhe Aredi Skora nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të cannabisit, pra nuk janë përdorues të saj”*.

6. Sa sipër sipas prokurorit nisur nga rrethanat e kësaj çështjeje penale, provat e administruara gjatë hetimit rezultoi e provuar se në rastin konkret i pandehuri Ervis Loga ka konsumuar elementët e veprës penale të “Prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike”, sipas nenit 283/1 të K.P, ndërsa i pandehuri tjetër Aredi Skora ka konsumuar elementët e veprës penale të “Moskallzimit të krimit”, sipas nenit 300 të K.Penal.

6.1 Këto fakte bazohen dhe rezultojnë të provuara nga: Proces-verbali i arrestimit së bashku me raportin e shërbimit dt.14.12.2020; Proces-verbalet e sekuestrimit të provës materiale (lënda e dyshuar si narkotike e llojit cannabis) dhe vendimet për kryerjen e ekspertimit kimik dhe toksikologjik dt.14.12.2020; Akti i ekspertimit toksikologjiko-ligjor me nr.2742 dhe 2743 dt.14.12.2020; Aktin e ekspertimit kimik me nr.1262 dt.03.02.2021; Proces-verbali ndaj të cilit zhvillohen hetimet të dyshuarve Ervis Loga dhe Aredi Skora si dhe aktet e tjera bashkëngjitur që i përkasin procedimit penal me nr.8922 vitit 2020.

7. I pyetur rreth akuzës, i pandehuri Ervis Loga, ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues për veprën e kryer.

7.1 I pandehuri Aredi Skora, nuk kanë mbajtur ndonjë qëndrim rreth akuzës, por kanë dhënë shpjegimet e tyre lidhur me ngjarjen.

8. Në këto kushte, në diskutimin përfundimtar organi i akuzës kërkoi deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Loga** për kryerjen e veprës penale të **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”** parashikuar nga neni **283/1** i K.Penal si dhe deklarimin fajtor të të pandehurit **Aredi Skora** për kryerjen e veprës penale të **“Moskallzimi i krimit”**, parashikuar nga neni **300** i K.Penal.

II. Vlerësimi i gjykatës.

• Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit Ervis Loga.

9. Gjykata vlerëson të theksojë se ekzistenca e përgjegjësisë penale në aspektin juridik kushtëzohet nga ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale. Në këtë kuptim, në mënyrë që një subjekt të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, për të cilën akuzohet, duhet që gjykata të analizojë respektivisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të figurës së veprës penale sipas rrethanave konkrete.

10. Në çështjen objekt gjykimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit Ervis Loga për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”,

parashikuar nga nenet 283/1 i Kodit Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: **“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”.**

10.1 Në lidhje me objektin e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Objekti i veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal mund të indentifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimat të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Në rastin konkret ky objekt rezulton të jetë cënuar me veprimet e kundërligjshme (të cilat do të analizohen më poshtë) të të pandehurit Ervis Loga.

10.2 Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Në kuptim të nenit 283 pg. 1 të Kodit Penal, legjislatori ka parashikuar se kjo vepër penale mund të kryhet me mënyra të ndryshme si: përmes shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo forme, transportimit, dërgimit, dorëzimit, mbajtjes, shpërndarjes, apo tregtimit në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jenë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.

11.1 Në çështjen konkrete, Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Ervis Loga e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kështu, rezulton e provuar se i pandehuri Ervis Loga mbante në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike, të llojit cannabis sativa, e cila ka rezultuar me peshë totale 6770 grame. Në bazë të Aktit Kimik me nr.1262, datë 03.02.2021 është konkluduar se: “Materiali bimor objekt ekspertimi është cannabis produkt herbal bimë cannabis sativa L dhe se pesha në total me ambalazh është 6770 gram”. Legjislatori ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë lëndë narkotike apo psikotrope në dozë të vogël dhe për përdorim vetjak, por në

rastin konkret ky parashikim nuk gjen zbatim.

11.2 Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale “nullum crimen, nulla poena sine culpa”, është element i përgjegjësisë penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë. Për të qenë para veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë vepër penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme lënde narkotike të llojit cannabis sativa, me peshë totale 6770 gram.

11.3 Në lidhje me subjektin e veprës penale. Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri Ervis Loga ka qenë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi dhe, si i tillë, ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volutive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe ta kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

12. Në referim të analizës së mësipërme, rezulton se janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, e për pasojë gjykata vlerëson se i pandehuri Ervis Loga duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e saj.

- **Në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.**

13. Dënimi penal përfaqëson shtrëngimin shtetëror që zbatohet ndaj subjekteve të deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin, por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përsëri në të ardhmen. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i

dobishmërisë dhe individualizimit të tij. Në vijim të këtij arsytimi, gjykata vlerëson t'i referohet nenit 47 të K. Penal, në analizë të së cilit, kriteret për caktimin e dënimit konsistojnë në:

i. Rrezikshmërinë e veprës penale. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Këtu, Gjykata thekson se paragrafi i parë i figurës së veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*" përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me burgim gjer në dhjetë vjet, që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjykata çmon se kjo veprë penale ka marrë një përhapje shumë të gjerë në komunitetin tonë. Prandaj, në caktimin e dënimit, Gjykata mban parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj veprë penale.

ii. Rrezikshmërinë e autorit. Në lidhje me këtë element gjykata duhet të ketë në konsideratë gjendjen sociale, profesionin, arsimimin, gjendjen familjare dhe atë gjyqësore. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. **Së pari:** gjykata mban parasysh personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, e cila nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton i padënuar më parë. **Së dyti,** mban parasysh sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale. Kështu i pandehuri që në momentet e para ka shfaqur pendesë për veprimet e kryera. Kjo tregon një sjellje të mirë të autorit pas kryerjes së veprës penale. **Së treti,** gjykata mban parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë i martuar, kryefamiljar me dy fëmijë të mitur **Së katërti,** Gjykata mban parasysh nivelin e tij arsimor, i cili rezulton të jetë me arsim të mesëm.

iii. Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Kjo për faktin, pasi i pandehuri ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*" dhe me ndërgjegje ka vepruar, duke mbajtur në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit cannabis sativa me peshë totale 6770 gramë.

iv. Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Në çështjen objekt gjykimi lidhur me rrethanat lehtësuese, duke patur parasysh se në referim të nenit 49 të K. Penal ato nuk janë shterruese, gjykata vlerëson të mbajë në konsideratë faktet se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë si dhe rezulton të jetë i padënuar më parë. Në lidhje me rrethanat rënduese, gjykata konstaton se nuk ekzistojnë rrethana të tilla.

14. Në referim të analizës së mësipërme, gjykata vlerëson të dënojë të pandehurin Ervis Loga me **6 (gjashtë) vjet burgim** për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Ervis Loga me **4 (katër) vjet burgim**. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanave të kryerjes dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret. Gjithashtu, dënimi i dhënë, do t'i shërbejë të pandehurit për edukimin e tij, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithshëm të këtyre veprës penale në shoqëri.

- **Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit Aredi Skora.**

15. Gjykata vlerëson të theksojë se ekzistenca e përgjegjësisë penale në aspektin juridik kushtëzohet nga ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale. Në këtë kuptim, në mënyrë që një subjekt të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, për të cilën akuzohet, duhet që gjykata të analizojë respektivisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të figurës së veprës penale sipas rrethanave konkrete.

16. Në çështjen objekt gjykimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit **Aredi Skora**, për veprën penale të *“Moskallëzim i krimi”*, parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *“Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Përjashtohen nga detyrimi për kallzim të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesi dhe të adoptuarit, si edhe personat që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo profesionit.”*

16.1 **Në lidhje me objektin e veprës penale “Moskallëzim i krimi”**. Gjykata thekson se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është parashikuar nga Kodi Penal në Pjesën e posacme të tij, në Kreun IX, të titulluar *“Vepra penale kundër drejtësisë”*. Objekt i këtyre veprave janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penale nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

16.2 **Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Moskallëzim i krimi”**. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Në kuptim të nenit 300 të Kodit Penal, figura e veprës penale *“Moskallëzim i krimi”* nga ana objektive krimi kryhet nëpërmjet moskallëzimit në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer. Kallëzimi është i detyruar me ligj për shtetasit kur ata marrin dënim për kryerjen e një krimi që është kryer ose që është duke u kryer, sikurse parashikon neni 300 i Kodit Penal.

16.2.1 Në çështjen konkrete, Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Aredi Skora e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kështu ka rezultuar e provuar se, të pandehurit Ervis Loga dhe Aredi Skora kanë qenë në të njëjtin vend në momentin e ndalimit të tyre nga shërbimet e policisë gjyqësore të sektorit kundër narkotikëve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Gjithashtu nga deklarinimet e vet të pandehurve ka rezultuar e provuar se i pandehuri Aredi Skora kishte dënim për lëndën narkotike që mbante i pandehuri Ervis Loga. Kete fakt kriminal, i pandehuri Aredi Skora nuk e ka kallëzuar në polici, siç ka detyrimin çdo shtetas.

16.3 **Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale**. Gjykata vlerëson se, kjo vepër penale kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë. Gjykata çmon se interpretimi i një elementi të ndërgjegjes së individit që kryen në një vepër penale është sa e vështirë ashtu edhe e rëndësishme për përcaktimin e fajësisë nëpërmjet kualifikimit ligjor. Natyrisht ky perceptim për gjykatën nuk duhet bërë mbi baza subjektive, por në bazë të *“leximit”* të

veprimeve konkrete dhe të vlerësimit në harmoni të të gjitha provave dhe të konkluzionit që del prej tyre. Pra, Gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarine kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurit Aredi Skora. Kështu, në plotësim të këtij elementi, Gjykata çmon se, i pandehuri ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke moskallëzuar lëndën narkotike që ndodhej në qesen e zezë plastike, brenda një pëlhere (copë/lecke), të cilën e mbante në dorë shtetasi Ervis Loga.

16.4 Në lidhje me subjektin e veprës penale. Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri Aredi Skora ka qenë madhorë e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi dhe, si i tillë, ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuaj nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojnë se po kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qenë i aftë të posedojnë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe ta kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

17. Në referim të analizës së mësipërme, rezulton se janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, e për pasojë gjykata vlerëson se i pandehuri Aredi Skora duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e saj.

- **Në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin Aredi Skora.**

18. Dënimi penal përfaqëson shtrëngimin shtetëror që zbatohet ndaj subjekteve të deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin, por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përsëri në të ardhmen. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij. Në vijim të këtij arsytimi, gjykata vlerëson t'i referohet nenit 47 të K. Penal, në analizë të së cilit, kriteret për caktimin e dënimit konsistojnë në:

i. Rrezikshmërinë e veprës penale. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Këtu, Gjykata thekson se figura e veprës penale “Moskallëzim i krimit” përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet, që paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore. Gjykata çmon se kjo vepër penale ka marrë një përhapje shumë të gjerë në komunitetin tonë. Prandaj, në caktimin

e dënimit, Gjykata mban parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj veprë penale.

ii. Rrezikshmërinë e autorit. Në lidhje me këtë element gjykata duhet të ketë në konsideratë gjendjen sociale, profesionin, arsimimin, gjendjen familjare dhe atë gjyqësore. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. **Së pari:** gjykata mban parasysh personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, e cila nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton i dënuar më parë. **Së dyti,** mban parasysh sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale. Kështu i pandehuri në seancë gjyqësore e ka pranuar autorësinë e veprës. Kjo tregon një sjellje të mirë të autorit pas kryerjes së veprës penale. **Së treti,** gjykata mban parasysh moshën e të pandehurit, i cili është 26 vjec. **Së katërti,** Gjykata mban parasysh nivelin e tij arsimor, i cili rezulton të jetë me arsim të mesëm.

iii. Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Kjo për faktin, pasi i pandehuri ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale “*Moskallëzimi i krimi*” dhe me ndërgjegje ka vepruar, duke moskallëzuar lëndën narkotike që mbante i pandehuri Ervis Loga.

iv. Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Në çështjen objekt gjykimi lidhur me rrethanat lehtësuese, duke patur parasysh se në referim të nenit 49 të K. Penal ato nuk janë shterruese, gjykata vlerëson të mbajë në konsideratë faktin se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë. Në lidhje me rrethanat rënduese, gjykata në çështjen objekt gjykimi mban parasysh faktin që ndaj të pandehurit Aredi Skora konstatohet rrethana rënduese “*kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë*”, parashikuar nga gërma “ç” e nenit 50 të Kodit Penal.

25. Në referim të analizës së mësipërme, gjykata vlerëson të dënojë të pandehurin Aredi Skora me 1 (një) vit burgim për kryerjen e veprës penale “*Moskallëzimi i krimi*”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të pandehurit i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 9 (nëntë) muaj burgim.

• **Në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë.**

26. Në referim të nenit 59 të K. Penal, “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë*”, rezulton se, nisur nga rrezikshmëria e pakët e personit, mosha e tij, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep një dënim me burgim deri në pesë vjet, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit të dënimit dhe të vendosë të dënuarin në provë, me kusht që gjatë kësaj kohe ai të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.

26.1 Në çështjen objekt gjykimi, gjykata ka vlerësuar që i pandehuri të dënohet përfundimisht

me 9 (nëntë) muaj burgim. Po kështu, rezulton se ai: ka rrezikshmëri të pakët shoqërore; me gjendje civile beqar, 26 vjec, është penduar për veprën e kryer. Në këto kushte, rezulton se plotësohen kërkesat e parashikuara nga neni 59 i K. Penal, e për rrjedhojë gjykata vlerëson të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të pandehurit Aredi Skora, duke e vendosur atë në provë për një afat 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale.

- **Në lidhje me shpenzimet procedurale**

27. Në bazë të nenit 393/1 dhe 485/3 të K. Pr. Penale, shpenzimet procedurale të fazës së hetimit, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurve Ervis Loga dhe Aredi Skora solidarisht.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 190, 379, 380, 384, 390, 394, 403, 404, 405, 406, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 1/c, 22, 47-49, 59 dhe neneve 283/1 dhe 300 të K.Penal,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Loga** për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni **283/1** i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Ervis Loga** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 4 (katër) vjet burgim.
3. Vuajtja e këtij dënimi ka filluar nga dita e arrestimit të tij, më datë 14.12.2020. Dënimi do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aredi Skora** për kryerjen e veprës penale të “**Moskallëzimi i Krimit**”, parashikuar nga neni **300** i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
5. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Aredi Skora** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 9 (nëntë) muaj burgim.
6. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi dhe vendosja në provë e të pandehurit **Aredi Skora**, për një afat 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe ai të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. Afati i kohës së provës për të pandehurin **Aredi Skora** fillon nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.
7. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale, prova materiale, e sekuestruar dhe konkretisht sasia e lëndës narkotike 6770 gram e llojit cannabis sativa L të asgjësohet.
8. Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurëve solidarisht.

9. Kundër ketij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
U shpall në Tiranë, sot më datë 08.07.2021.

SEKRETARE
GJYQTARE

Berzana
Armela HASANTARI

ÇOBO

Shpenzime gjyqesore
Shpenzime ne séance paraprake dhe themel
Njoftime 450 leke